



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 16/16 Prot

Vlorë, më 24.10. 2022.

VENDIM

Nr. 15 , datë 14.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR
PRODHIM HIDROENERGJETIK, ME VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE
ÇARSHOVË, BASHKIA PËRMET, QARKU GJIROKASTËR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1.Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, nëpërmjet Hec Çarshovë, të subjektit “KENXHI” sh.p.k, me vendndodhje: Përroi Çarshovës, Njësia Administrative Çarshovë, Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastrë.

2.Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (Përroi Çarshovës)

HEC “Çarshovë”

Vepra e marrjes

X 546956.21 Y 4444797.47 Z 388.2 m.m.n.d

Qllog= 2.5 m³/s

Baseni i Presionit

X 546507.30 Y 4444019.28 Z 386.57 m.m.n.d

Godina e Centralit

X 546532.13 Y 4443931.20 Z 349 m.m.n.d

Qllog-tot = 2.5 m³/s

Qmes = 1.65 m³/s

Qekol = 0.113 m³/s

Fuqia max e instaluar N=786 kwh

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike E= 2 988 144 kwh/vit.

Të mos kufizohet prurja ekologjike Qekol = 0.113 m³/s.

3.Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.



K R Y E T A R

FLAMUR MAMAJ